



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 738 Prot.

Roskovec, më 03 .02 2023

VENDIM

NR 12 .DATË 03 .02 .2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN JANAR 2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 27.01.2023, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Janar 2023.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 559/1 Prot.

Roskovec, më 30.01.2023

Procesverbal Nr.1

*-I mbajtur sot, date 27.01.2023, ora 12<sup>30</sup>, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Dhjetor 2022.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2022.
5. Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023.
6. Për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2026.
7. Për miratimin e listës së përfituesve nga programi "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara".
8. Për një shtesë në buxhetin e vitit 2023.
9. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023.
10. Për shtyrjen me një vit të afatit të vlefshmërisë së Planit Social të Bashkisë Roskovec.
11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 12<sup>40</sup>

Keshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, E.Çepele, L.Hoxha, L.Goga, B.Kuka, K.Hyska, G.Hoxha, V.Bakaj, H.Beqiraj, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne  
:Rr.Hazizi, B.Cobo, T.Kuka, A.Hazizi, D.Hoxha, V.Dogani, A.Sheme, B.Toska.

Prezent nga bashkia: Kryetarja M.Bufi, Dr.Ekonomise, Dr.Kultures, P/Dr.Juridike, P/Sherbimit Social, P/Sek.Qendres Komunitare, Dr.Urbanistikes, Sp/Dr.Juridike.

Me plotesimin e kuorumit ,kryetari hap mbledhjen.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 11 keshilltare.Para se te filloje me rendin e dites,Kryetari ben me dije se kemi disa saktesime titujsh te projekt-vendimeve dhe disa materjale shtese nga administrate te cilat duhet ti fusim ne rendin e dites.Saktesimi i titullit te pikes Nr.9 te rendit te dites "Per autorizimin e Kryetarit te Bashkise per konkurim ne projekte me donatoret".Saktesim i pikes Nr.10 te rendit te dites,pra i titullit te projekt-

vendimit “Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.47 date 17.05.2019 “Per miratimin e Planit Social te Bashkise Roskovec 2019-2022”.Materjalet shtese ne rendin e dites sot jane “Per miratim te projekteve prioritare per Bashkine Roskovec”, “Per nje ndryshim ne VKB Nr.102 date 23.12.2022 “Per miratimin e sistemit te pikezmit per programin e strehimit “Permiresim i kushteve te banesave ekzistuese,deri ne nje ndertim te ri”, “Vendosjen e truallit ne dispozicion per ndertimin e banesave sociale”,fondi shtese per programin e strehimit per vitin 2023 kontribut i bashkise,i cili do ti shtohet projekt-vendimit te pikes 8 te rendit te dites.Kryetari sqaron se jane urgjente per ti kaluar sot,pasi deri ne 31 Janar eshte e hapur thirrja per aplikim per keto projekte sociale.Hidhet ne votim ndryshimet dhe shtesat e bera si me siper per ti futur ne rendin e mbledhjes se sotme dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro,ndryshimet dhe shtesat e bera.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i mbledhjes bashke me ndryshimet dhe shtesat e bera si me siper dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

2.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Dhjetor 2022.

Sekretarja e keshillit sqaron informacionin,i cili ka te bej me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar.3 vendime ishin akte normative te cilat jane miratuar nga Prefektura Fier.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Nuk ka diskutime.Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Dhjetor 2022.

P/Sherbimit Social Sidorela sqaron projekt-vendimin e 6%.Elmazi-ka ndonje vendim qeverie per shtese per keta qytetar?Sidorela-jo,pervec asaj qe u dha ne Dhjetor,ne fund te vitit.Vendim tjetër nuk na ka ardhur nga qeveria.Hidhet ne votim projekti i 6% per muajin Dhjetor 2022 dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

5.Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike,nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023.

Sidorela sqaron projektin dhe kriteret qe duhet te plotesohen per te perfitur nga fondi 6%.Sidorela sqaron kriteret sipas radhes,keto kriterë jane sipas percaktimeve ligjore.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekt-vendimi i kriterëve per familjet qe do trajtohen me fondin 6% per vitin 2023 dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

6.Per miratimin e Planit te Integritetit 2023-2026.

Dr.Kultures Enirjeta Bufi sqaron planin e integritetit per Bashkine Roskovec.Plani eshte pergatitur nga grupi i punes me asistence te eksperteve nga Instituti per Demokraci dhe Ndermjetesim.Ky plan do te udheheq punen e Bashkise Roskovec,duke permiresuar kuadrin e brendshem rregullator ne aspekte te etikes dhe integritetit.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim Plani i Integritetit 2023-2026 dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

7. Për miratimin e listës së përfituesve nga programi“Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”.

P/Dr.Juridike Drinalda Fejzulla sqaron projektin.Bashkia ka aplikuar per fonde dhe do mbuloj 40%.Kane ardhur kerkesat eshte bere vleresimi i tyre dhe u eshte paraqitur lista e perfituesve.Kryetarja-nevoja per permiresime dhe nderhyrje kane te gjitha familjet,por kjo funksionon mbi bazen e kerkesave.Kemi pasur 74 kerkesa ne total per disa vite.Kete here ka qen ndryshe,keto kerkesa u moren ne konsiderate,u be verifikimi i tyre ne terren,dhe si perfundim ju

kemi paraqitur listen sipas frymeve, sipas te ardhurave qe kane. Kete projekt 40% duhet ta financoj bashkia dhe 60% Ministria. Elmazi- duke pare materjalin, nese ju i keni besuar grupit te punes te cilet kane ber materjalin, sugjeroj te mos leme jasht ndonje qe eshte me keq, duke qene se zona jone eshte e varfer. Duke i besuar komisionit mendoj ta kalojme kete projekt. Leksi-pyet per Zhaneta Hatillarin per sakesimin e mbiemrit. Kryetarja-sot ju kemi sjelle listen e sakte me ndryshimet e bera. Leksi-per familjen e Vangjeli Goga, a kane qene dakort ata? Sara Kuka-te gjithë personat jane thirrur dhe kane rene dakort, Laurenc Goga ka ardhur vet qe ka bere aplikimin dhe ka plotesuar deklaraten vet dhe e ka firmosur. Leksi-Gramoz Duka, pyet pse nuk eshte ne liste? Kryetarja-sdo kete permbushur kriteret e duhura. Pjesa tjetere e kerkesave te bera do jene ne pritje dhe do shqyrtohen vitet e tjera ne vazhdim. Eneida-per Gramozin eshte bere verifikim, por ka pas kerkesa te tjera qe ishin me keq se ai. Pra kete here jane futur ato kerkesa qe plotesonin kriteret dhe qe ishin ne gjendje me te keqe se te tjerat. Nuk ka me pyetje. Hidhet ne votim projekt-vendimi i listes se perfituesve nga programi permiresimi i kushteve te banimit per komunitete te varfere dhe te pafavorizuara, sipas listes se sakesuar sot, dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

8. Per nje shtese dhe ndryshim ne buxhetin e vitit 2023.

Dr. Finances sqaron projektin, sipas materjalit te paraqitur. Sqaron te ardhurat e trasheguara nga viti 2022 te cilat do te shtohen ne buxhet, dhe do te jene per shlyerjen e detyrimeve qe rrjellin nga kontratat per sherbime dhe mallra ndaj te treteve nga viti 2022 per bashkine dhe 2 ndermarrjet vartese, sipas llogarive te percaktuara ne tabelen bashkelidhur. Selmani sqaron edhe fondin shtese qe shtuam sot, per programin e strehimit per vitin 2023, duke bere edhe ndryshimet ne buxhet sipas materjalit te paraqitur. Hidhet ne votim projekt-vendimi i nje shtese dhe ndryshim ne buxhetin e vitit 2023 dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

9. Per autorizimin e Kryetarit te Bashkise per konkurim ne projektet me donatoret.

Dr. Finances sqaron projektin sipas materjalit. Sqaron edhe sakesimin e titullit si me siper. Ky projekt ka te bej me miratimin e fondit me bashkefinancim nga bashkia Roskovec dhe UNDP per projektin "Askush te mos mbetet pas" sipas vleres qe keni ne projekt. Si dhe miratimin e fondit me bashkefinancim nga bashkia dhe Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes sociale per projektin "Te kaffja e gjyshit". Nese shpallemi fitues tek keto projekte do behen ndryshimet ne buxhetin 2023. Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

10. Per nje ndryshim ne Vendimin Nr.47 date 17.05.2019 "Per miratimin e Planit Social te Bashkise Roskovec 2019-2022".

Nertila P/Sektorit sqaron projektin i cili konsiston ne shtyrjen me 1 vit te zbatimit te implementimit te Planit Social te bashkise, te cilin ju e keni miratuar kete plan ne vitin 2019. Kerkojme shtyrjen e ketij plani per te marr pjese ne thirrjet per aplikim projektesh te kujdesit shoqeror nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Plani Social aktiv perben nje nga kriteret themelore per pranimin e projekt-propozimit te bashkise ne kete thirrje, sipas shkreses qe na ka ardhur. Nertila sqaron se shtyrja e afatit te zbatimit te ketij plani, me nje vit eshte kriter per dorezimin e aplikimit, permes te cilit bashkia synon ngritjen dhe fuqizimin e metejshe me sherbimeve shoqerore ekzistuese. Nuk ka diskutime. Hidhet ne votim projekt-vendimi i ndryshimit te VKB Nr.47 date 17.05.2019, shtyrjen me 1 vit te zbatimit te Planit Social dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

11. Per vendosjen e truallit ne dispozicion per ndertimin e banesave sociale.

Drinalda sqaron projektin. Trualli do vendoset ne dispozicion per ndertimin e banesave sociale, per familjet qe u kane shkare banesat ne fshatin Mbers. Kryetarja-kjo siperfaqe kam djene qe Keshilli i

Ministrave i ka kaluar,presim vetem vendimin.Pas aplikimit,do e cojme te gjithë informacionin edhe emergjencave civile ne Tirane.Kryetarja sqaron se ka dal dhe studimi i Institutit te Gjeologjise e cila konfirmon se trualli qe keto familje kane pasur ne pronesi nuk eshte i pershtatshem per banesa,dhe shkarja e tokes mund te shkaktoj probleme serioze.Kryetarja sqaron se do i bejme te gjitha procedurat per ti ndihmuar keto familje qe te vendosen ne kete truall,por nese ata nuk do pranojne,eshte zgjedhja e tyre pastaj.Hidhet ne votim projekti i vendosjes se truallit ne dispozicion per ndertimin e banesave sociale sipas siperfaqes dhe zones kadastrale ne materjal,dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

12.Per nje ndryshim ne VKB Nr.102 date 23.12.2022 “Per miratimin e sistemit te pikezimit per programin e strehimit “Permiresim i kushteve te banesave ekzistuese,deri ne nje ndertim te ri”.

Drinalda sqaron se kemi pasur nje problem me sistemin e pikezimit.Sqaron se maksimumi i pikeve qe lejohet nga sistemi per cdo kusht eshte 25 pike.Konkretisht do ndryshohet tabela nr.1 formula e pikezimit per aplikantet,te cilen e keni bashkelidhur.Vleresimi me pike per aplikantet qe kane kaluar fazen e pare behet ne baze te kushteve sociale,familjare,ekonomike dhe kushteve te strehimit.Per secilin nga keto kushte piket maksimale jane 25.Hidhet ne votim ndryshimi i VKB Nr.102 date 23.12.2022 sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

13.Per miratim te projekteve prioritare per Bashkine Roskovec.

Dr.Urbanistikes Eneida sqaron projektet prioritare qe bashkia ka percaktuar sipas listes qe cdo keshilltar ka.Eneida sqaron listen e prioriteteve duke i permendur secilen prej tyre sipas listes.Kryetarja sqaron se ka disa fusha sportive te cilat jane parashikuar per tu realizuar kete vit.Sistemi fotovoltaiq,do filloj puna per vendosjen e paneleve ne kopshtin nr.1,pyllezimi i brezit te gjelbert Suk-Jagodine-Marinez ka nje pjese kete vit,per shkollen e Kumanit eshte realizuar catia,per pjesen tjeter shpresojme ta mari qeveria.Sqaron linjen e perpunimit te perimeve te fushes dhe i produktit ndryshe.Per Posten e Policise presim financim,eshte pjese e projektit te Bllokut Nr.3.Eneida sqaron se lista e projekteve prioritare eshte bazuar ne nevojat emergjente te fatkeqesive natyrore si dhe restaurime te godinave arsimore,projekte inovatore te energjise se rinovueshme,menaxhimi i mbetjeve,rikualifikimi urban etj.Hidhet ne votim miratimi i projekteve prioritare te bashkise sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

14.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Elmazi-duke degjuar dhe shqetesimin e qytetareve,ne nuk e dim sesi funksionon policia.Ne lagjen nr.1 dhe nr.2 ne nuk shikojme patrulla policie,aty xhirojne makinat me shpejtesi.A ka patrulla policie ne fshatra?Shefi i Policise i cili eshte prezent ne mbledhje sqaron menyren sesi funksionon Posta e Policise per qytetin dhe fshatrat.Qyteti mbulohet nga 1 patrulle,ne fshat mbulohet nga inspektori i zones dhe shefi i krimeve.Nga ana jone dergojme patrulla edhe naten.Patrulla e policise,patrullon ne gjithë qytetin dhe jane marr masa per cdo shkelje.Per keto 2 muaj qe jam une ne detyre ska pas vjellje,ska pasur ankesa as neper fshatra per vjellje.Per xhirimin e makinave nga ana jone jane marr te gjitha masat,por edhe do i shtojme akoma.Elmazi-2 polica nuk e bejne dot per te gjitha lagjet.Komandanti-ata nuk rrine ne nje pike,jane ne levizje,tek shkolla rrin me teper se e kemi prioritet.Elmazi-ka rruge qe duhen bere me 1 sens levizje,jam dakort ne shkolla policet duhet te jene me patjeter,per rrugoren duhet te permiresohen.Leksi-falenderon komandantin per ardhjen sot,ngre shqetesimin se nuk duhet te tregohen te forte me njerzit hallexhinj,mos te kemi dy standarte,nese ata ndalojne per pak mos tu vihet gjobe.Kontroll edhe per makinat me xhama te zinj,ne kerkojme impenjim nga ju.Komandanti-do permiresohet kjo gje.Leksi-ankese nga qytetaret per faturat e OSHE-se,i kane paguar tek posta per 2013 dhe ju vijne perseri keto pagesa ne

fatur.Kryetarja-me sill disa fatura ne zyre qe ti verifikoj me ata te OSHE-se.Leksi-pyet per pallatin 6 katesh per te pastrehet,ne cfare faze eshte qe te dim si tu shprehemi qytetareve kur na pyesin.Kryetarja-Kemi informacion se eshte ne proces prokurimi,ka dal leja e ndertimit,eshte pune ditesh.Durim Bakaj-Ne Mbers prej 1 viti nuk ka kryetar fshati dhe banoret per nje vertetim ven ne Vlosh.Kryetarja e sqaron.Durimi-fshati Mbers nuk ka infermier.Kryetarja-do i dergoj shkrese per kete problem institucionit perkates.Durimi-rruga e vjeter tek lagja e Bakallareve eshte e ndare ne mes,nuk kalojme dot,ka nevoje per tombino.Nuk ka me diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**



**Kryetar**

**Kadri Hyska**

